

Detyrimi i autoriteteve publike për të dhënë informacion për çështjet mjedisore rrjedh edhe nga Konventa e Aarhusit dhe nenin 47 të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ku parashikohet se: *“Çdo personi fizik dhe juridik i sigurohet informacioni i disponueshëm për mjedisin, pa qenë nevoja të shfaqë një interes specifik për të.”* Ligji 10440, dt.07.07.2011, *“Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”* përcakton në nenin 14 të tij se cilët janë aktorët që marrin pjesë në procedurën e ndikimit në mjedis, ku krahas autoriteteve publike të përfshira dhe subjektit, pjesëmarrës është edhe publiku.

Në mënyrë të detajuar procesi i përfshirjes së publikut në llojet e ndryshme të procedurave të lidhura me vendimmarrjen mjedisore, deri në këtë moment, rregullohej nga VKM Nr.994, dt.02.07.2008, *“Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”*. Kjo VKM ka qenë në fuqi deri në datë 30 prill të vitit 2014, kur është miratuar VKM Nr.247, *“Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore.”* Hapat proceduralë që duhet të respektohen nga subjekti dhe nga autoritetet publike janë si vijon:

*3. Për veprimtaritë, që kanë ndikim në mjedis, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave siguron pjesëmarrjen e publikut, duke zbatuar këto procedura:*

*a) Brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për t'u pajisur me leje mjedisi, i kërkon kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, ku do të zbatohet projekti, të organizojë diskutimin me publikun e ndikuar;*

*b) Dërgon në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dokumentet e projektit a të veprimtarisë, për t'ia vënë në dispozicion publikut.*

*Me këto dokumente kuptojmë:*

*i) Një përmbledhje të projektit teknik dhe të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të veprimtarisë, e cila hartohet nga kërkuesi në 10 kopje;*

*ii) Projektejen mjedisore për veprimtarinë, në 5 kopje;*

*iii) Tri kopje të dosjes së plotësuar nga kërkuesi, kur pjesëtarë të publikut duan të njihen në mënyrë të plotë me të.*

c) *Materialet e kërkuara në shkronjën "b" të kësaj pike, hartohen në gjuhën shqipe dhe me terminologji të thjeshtë.*

4. *Njësia e qeverisjes vendore dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me mjetet e mundësitë, që kanë, njoftojnë publikun e ndikuar, brenda 5 ditëve, nga data e marrjes së dokumenteve të përmendura në shkronjën "b" të pikës 3 të këtij vendimi.*

5. *Njoftimi hartohet me shkrim dhe publikohet gjatë 20 ditëve pa ndërprerje:*

a) *në radio e tv-të vendore;*

b) *në faqen e internetit të organit;*

c) *në botime të përditshme apo periodike, kur është e mundur;*

ç) *në tabelën e njoftimeve të njësisë së qeverisjes vendore.*

6. *Njoftimi i qeverisjes vendore përcakton:*

a) *vendin, ku qëndron i depozituar dokumentacioni;*

b) *afatin kohor për dhënien e mendimit, i cili është jo më pak se 1 muaj nga data e fundit e shpalljes së njoftimit;*

c) *vendin, datën dhe orën e organizimit të diskutimit me publikun e ndikuar.*

7. *Në diskutimin me publikun marrin pjesë specialistë të ministrisë, kërkuesi, me ekspertët e certifikuar, që kanë përgatitur raportin e VNM-së, specialistë të ministrive, që kanë lidhje me këtë veprimtari.*

8. *Specialistët e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave mbajnë procesverbalin e takimit, ku shënohen të gjitha sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet e publikut.*

Përfshirja e publikut gjatë procedurës së thelluar në ndryshim nga procedura paraprake, përmban më shumë faza për shkak se projekti i propozuar nga zhvilluesi ndodhet tashmë në një stad më të avancuar. Informacioni dhe dokumentacioni që duhet t'i vendoset në dispozicion publikut është më i gjerë dhe rëndësia e pjesëmarrjes së tij në vendimmarrje është më e madhe.

Për të pasur një proces sa më transparent, këto organe duhet t'i publikojnë menjëherë në faqen e tyre të internetit të dhënat e monitorimit. Më pas çdo palë e interesuar ka të drejtë që të marrë një

kopje të të dhënave të monitorimit të paraqitura nga zhvilluesi pas paraqitjes së kërkesës pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo Agjencisë Rajonale të Mjedisit.